



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

14-020/05-20903/24, më 06-02-2024

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

**V E N D I M**

- I. Miratohet vendimi për caktimin e komisionit për vlerësimin e gjendjes fizike të objekteve të cilat menaxhohen nga Kryeqyteti.
- II. Anëtarët e komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:
  1. Fatmir Bilalli, Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë, kryesues;
  2. Gëzim Restelica, Sektori i Prokurimit, anëtar;
  3. Vebi Lipa, Drejtorja e Inspektionit, anëtar;
  4. Nazife Krasniqi, Drejtorja e Urbanizmit, anëtare;
  5. Bedri Sylejmani, ekspert i jashtëm i angazhuar në DIKMK, anëtar.
- III. Detyrat e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi janë:
  - Përpilimi i një raporti të brendshëm, të detajizuar, për gjendjen dhe të gjitha procedurat e zhvilluara, për punimet në kulmin e objektit të Komunës në Arbëri;
  - Përpilimi i një raporti për vlerësimin e strukturës, rrezikut potencial dhe intervenimeve eventuale lidhur me gjendjen e kulmit në ndërtesën e renovuar të Brigadës së Zjarrfikësve;
  - Vlerësimi i rrezikut në të gjitha ndërtesat e Kryeqytetit, përfshirë shkollat, institucionet parashkollore, qendrat e mjekësisë familjare etj, me qëllim të evidentimit të rrezikut nga ndonjë avari e mundëshme, në koordinim me drejtuesit e këtyre institucioneve.
- IV. Për kryerjen e detyrave si në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Kryeqytetit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

**I DORËZOHET:**

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT  
Përparim Rama

